



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.1014/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Milena Gjeriq e Valon Totaj anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi - Saraçi, në çështjen kontestimore të paditësit I. M nga Malisheva, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Xh. B avokat në Prishtinë, kundër të paditurës S... me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson L. B, për shkak të kompensimit të dëmit, në vlerë 3,760.00€, duke vendosur sipas ankesës së paditësit dhe ankesës së të paditurës, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1651/14 të datës 19.06.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.11.2021, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Me miratimin e pjesërishëm të ankesës së paditësit I. M nga Malisheva, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1651/14 të datës 19.06.2019, në pjesën që ka të bëjë me kamatën dhe gjykohet: Kamata e gjykuar, caktohet si kamatë ligjore prej 8 % e cila për dëmin material të pësuar nga paditësi do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë 09.06.2014, ndërsa për dëmin jomaterial nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit 19.06.2019, e deri në pagesën përfundimtare, ndërsa sa i përket pjesës tjetër të dispozitivit ankesa e paditësit dhe ankesa e të paditurës refuzohen si të pa bazuara dhe aktgjykimi i atakuar me ankesë në këtë pjesë vërtetohet.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit I. M nga Malisheva. Në pikën I., të dispozitivit detyrohet e paditura S... në Prishtinë, që paditësit në emër të dëmit material dhe jomaterial, për aksidentin e datës 12.05.2014, t'ia paguaj shumat si vijon: në emër të dhembjeve trupore-fizike, shumën 1,500.00€, në emër të frikës, shumën 1,000.00€, në emër të ushqimit të përforcuar, shumën 100.00€, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, shumën 100.00€. Në pikën II., të dispozitivit detyrohet e paditura S..." në Prishtinë, që paditësit si në pikën I., të dispozitivit të aktgjykimit, t'ia paguaj me kamatë ligjore si në mjetet e deponuara në bankë për një vit pa destinim të caktuar prej datës së marrjes së aktgjykimit 19.06.2019 deri në pagesën definitive, për pjesën e gjykuar të kompensimit, si dhe shpenzimet e

procedurës në shumë 599.00 të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Në pikën III., të dispozitivit refuzohet e pa bazuar pjesa e kërkesëpadsisë së paditësit, në emër të dëmit jomaterial, mbi shumat e gjykuara dhe atë në emër të kompensimit: për dhembje trupore, shumën 500.00€, për frikën e përjetuar, shumën 500.00€, ndërsa pjesërisht është refuzuar kërkesa për kompensimin e dëmit material, refuzohet në emër të ndihmës së personit të tretë, në shumën 40.00€, në emër të ushqimit të përforcuar, në shumën 20.00€.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë kanë paraqitur paditësi, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës të aprovoj ankesën dhe kërkesëpadinë e paditësit, sa i përket dëmit jomaterial të aprovoj në tërësi.

Kundër të njëjtit aktgjykim ankesë ka parashtruar edhe e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ankesën e të paditurës ta aprovoj, aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit:**

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi I. M ka parashtruar padi ndaj të paditurës S..., me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që ta kompensoj paditësin dhe atë për të gjitha format e dëmit, shumën 3,760.00€ të gjitha me kamatë ligjore nga dita e paraqitjes së padsisë. Të obligohet e paditura edhe për shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat si: raporti policor me numër 2014-GE-284 i datës 12.05.2014, ekspertiza mjekësore e datës 03.04.2019 punuar nga eksperti Dr. Xh. S - Ortoped - Traumatolog dhe Dr. S. B-Psikiatër, raportet mjekësore të bashkangjitura në shkresa të lëndës, deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se nuk është kontestuese baza e kërkesëpadisë, nuk është kontestuese se aksidenti ka ndodhur me datë 12.05.2014, nuk është kontestuese se paditësi nga ky aksident ka pësuar lëndime të lehta trupore, nuk është kontestuese se deri te aksidenti ka ardhur me fajin e të siguruarit të të paditurës S..., mirëpo kontestuese është vetëm lartësia e kërkesëpadisë e kjo për faktin se përfaqësuesi i të paditurës gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë por vetëm lartësinë e saj.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

### **Baza ligjore:**

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj: .....d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj: .....e) ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë”.

### **Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:**

Nga gjendja e vërtetuar faktike, kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqës, ka marrë aktgjykimin, i cili sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit, është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete edhe për faktet vendimtare. Kolegji gjenë se, gjykata e shkallës së dytë, ka dhënë shpjegimet dhe arsyet e nevojshme dhe është bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje kontestuese.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton edhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me

shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se në rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e vendimit gjyqësor ka dhënë arsye të plota lidhur me mënyrën e vendosjes duke u mbështetur në provat e nxjerra, nga të cilat është vërtetuar se në aksidentin e komunikacionit të datës 12.05.2014, paditësi ka pësuar dëmin e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor.

Kolegji gjen se në këtë çështje nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë, por vetëm lartësia e saj. Kolegji gjen se, paditësi dhe e paditura kontestimet e veta i kanë adresuar në drejtim të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Në këtë pikë, kolegji gjen se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë për faktin se me ekspertimin e kryer nga ekspertët mjekësor, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar shkallën dhe natyrën e lëndimeve e që në mënyrë të detajuar janë dhënë në ekspertizën e bërë nga ekspertët Dr. Xh. S dhe Dr. S. B.

Kolegji gjen se, lëndimet e pësuar nga paditësi, nga ana e ekspertëve mjekësor janë cilësuar si lëndime të lehta trupore. Në nenin 174 të LMD-së është përcaktuar se: *“Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim”*. Kolegji nuk i ka miratuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse, për faktin se gjykata e shkallës së parë për një vendosje të tillë është bazuar në provat e shtjelluara, dhe se kompensimi i shumave që janë aprovuar është në proporcion me të mirën e cenuar dhe se një mënyrë e tillë e kompensimit, është një satisfaksion për paditësin dhe sa do pak do t'i mundësojë ta kalojë sa më lehtë atë që e ka përjetuar në këtë fatkeqësi të komunikacionit.

Kolegji ka miratuar pretendimet ankimore të paditësit sa i përket kamatës dhe ka bërë ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, duke caktuar kamatën e cila vlen për vonesa në përmbushjen e detyrimeve në të holla, në kuptim të nenit 382.2 të LMD-së, në të cilin parashihet se: *“Lartësia e kamatë vonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj të veçantë”*. Në këtë pjesë, kolegji ka gjetur se, mënyra se si ka qenë e vendosur në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, përkon me mënyrën e vendosjes sipas LMD-së së vjetër, sipas të cilit në kuptim të nenit 277 të këtij ligji kamata caktohet si kamatë si për mjetet e deponuara në bankë pa destinim të caktuar. Meqenëse, shkaktimi i dëmit ka ndodhur në vitin 2014, kur e ka qenë në fuqi Ligji (i Ri) për marrëdhëniet e detyrimeve, atëherë kolegji duke u bazuar në nenin 382.2 të këtij ligji, ka vendosur që kamata e gjykuar caktohet si kamatë ligjore prej 8 % e cila për dëmin material të pësuar nga paditësja do të llogaritet nga dita e parashtrimit të

padisë 09.06.2014, ndërsa për dëmin jo material nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit 19.06.2019, e deri në pagesën përfundimtare.

Kolegji i ka refuzuar edhe pretendimet e të paditurës, lidhur me lartësinë e shpenzimeve të procedurës, pasi që ka vlerësuar se shpenzimet e tilla që janë vendosur nga ana e gjykatës së shkallës së parë, paraqesin shpenzime të dosmosdoshme për zhvillimin e kontestit dhe janë në përputhje të plotë me nenin 454 të LPK-së: i cili përcakton se: “Pala ka për detyrë që pavarësisht nga ajo se cili e ka fituar procesin gjyqësor, t’ia shpërblej palës kundërshtare shpenzimet që ia ka shkaktuar me faj të vet ose me rastin që i ka ndodhur asaj”.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) dhe e) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1014/20 me datë 16.11.2021

Kryetari i kolegjit- gjykatësi,

Dr.sc. Rafet Haxhaj